



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA KAMËZ**

NJOFTIM PËR KONSULTIM ME PUBLIKUN

**DREJTUAR BANORËVE TË BASHKISË KAMËZ DHE TË GJITHË PALËVE TË
INTERESUARA.**

Në mbështetje dhe zbatim të ligjit Nr. 146/2014 “ Për njoftimin dhe konsultimin publik” në nenin 9, pika 1, 3 , të ligjit nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore neni 18, në rregulloren e Këshillit Bashkiak, për konsultimin publik”.

Titulli i projekt-aktit që hapet për konsultim me publikun:

**“MIRATIMI I PLANIT VENDOR TË VEPRIMIT PËR MBROJTJEN E FËMIJËVE 2026-
2030, PËR BASHKINË KAMËZ”**

Ftojme të gjithë grupet e interesit si: prindër, mësues, banorë të Bashkisë Kamëz , administratorët e njësive dhe lagjeve administrative të Bashkisë Kamëz, ndërlidhës të lagjeve administrative, biznese, grupet e marginalizuara, të rinj/ të reja, shoqërinë civile, etj., të bëhen pjesë e kësaj dëgjese për një proces transparent dhe gjithëpërfshirës.

Konsultimi publik do të zhvillohet sipas kalendarit të mëposhtëm:

Datë: 27/02/ 2026

Ora: 11:00

Vendi: Pallati i Kulturës “Artan Cuku”, salla e Rinisë

Ky takim ka si qëllim kryesor bashkëpunimin dhe mbledhjen e rekomandimeve, të cilat do të shërbejnë për hartimin e Planit Vendor të Veprimit për Mbrojtjen e Fëmijëve.

Mirëpresim rekomandime, propozime dhe sugjerime konkrete, të cilat mund të dërgohen në adresën e mëposhtme të e-mailit:

-konsultim.publik@kamza.gov.al Koordinator për Njoftimin dhe Konsultimin Publik

Pranohen rekomandime deri më datën 27.02.2026.

Kjo dëgjese do të zhvillohet në bashkëpunim me Bashkinë, Njësitë dhe Lagjet Administrative të Bashkisë Kamëz, Anëtarë/përfaqësues të Këshillit Bashkiak Kamëz.

Jeni të lutur të merrni pjesë, pasi pjesëmarrja juaj është shumë e rëndësishme.